



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS



METODOLOGJI E ZHVILLIMIT TË PROJEKTIT PROFESIONAL

Ngarkesa: 6 ECTS | 60 orë mësimore (20 leksione + 40 seminare)

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: Viti akademik 2026-2027, Viti II, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë me detyrim

Programi i studimit: Programi i Studimit Profesional dyvjeçar në "Komunikim shumëgjuhësh në Institucione dhe Ndërmarrje "

Kodi i etikës: Kodin e Etikës së UT-së, (Nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat specifike lëndore:

Në përfundim të kursit, studentët pritet të kenë aftësinë të:

1. Kuptojnë konceptet bazë dhe terminologjinë e menaxhimit të projektit, duke përfshirë fazat e ciklit të jetës së projektit dhe rolet e aktorëve të ndryshëm.
2. Aftësohen në përdorimin e metodave dhe teknikave të planifikimit, si përcaktimi i objektivave SMART, krijimi i strukturës së punës (Work Breakdown Structure), si dhe përdorimi i instrumenteve për planifikim kohor dhe buxhetor.
3. Zhvillojnë aftësi pune në grup dhe komunikimi ndërkulturor, duke u përgatitur për të bashkëpunuar në projekte shumëdisiplinore dhe shumëgjuhëshe në një kontekst evropian dhe ndërkombëtar.
4. Njohin dhe zbatojnë instrumentet për monitorim, raportim dhe vlerësim, duke u fokusuar te rëndësia e transparencës, matjes së impaktit dhe menaxhimit të rreziqeve.
5. Lidhin teorinë me praktikën profesionale përmes simulimeve, punëve të grupit dhe detyrave praktike që reflektojnë situata reale nga institucionet dhe ndërmarrjet.

Rezultatet e pritshme lëndore:

1. Analizojnë dhe identifikojnë të gjitha fazat e zhvillimit të një projekti profesional, duke evidentuar sfidat dhe mundësitë që paraqiten në secilën prej tyre.
2. Përpilojnë një plan projekti të plotë, të strukturuar sipas standardeve profesionale (objektiva të matshme, aktivitete të detajuara, afate kohore, buxhet të balancuar dhe indikatorë performance).
3. Zbatojnë parimet e komunikimit shumëgjuhësh dhe ndërkulturor, duke hartuar dokumente (email-e, raporte, prezantime) në gjuhë të ndryshme dhe duke i përshtatur ato sipas kontekstit kulturor.
4. Përdorin teknologji dhe mjete dixhitale (p.sh. Gantt chart për planifikim kohor, Trello dhe MS Project për menaxhim aktivitetesh, Excel për buxhetim), duke integruar aftësitë digjitale në procesin e menaxhimit.
5. Përgatisin, prezantojnë dhe mbrojnë një projekt profesional praktik në grup, duke demonstruar aftësitë e tyre në bashkëpunim, argumentim dhe zgjidhje kreative të problemeve.